



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 13 datë 28.02.2022

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË 20 PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR INDIVIDË/FAMILJE QË NUK PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË. NË VLERË TOTALE 271.000 LEKË/MUAJ, NGA TË CILAT 143.000 LEKË/MUAJ NGA BUXHETI I SHTETIT DHE 128. 000 LEKË/MUAJ, BASHKIA GJIROKASTËR.

Në mbështetje të nenit 24 pika 2, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; neni 39, pika 3 të ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", VKM nr. 384 datë 12.06.2019 "Për caktimin e dokumentacionit për të përfutuar sipas programit social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendor", VKM, nr. 362, "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet Buxhetit të Shtetit dhe Qeverisjes Vendore, mënyrën e llogaritjes së tij", VKB-së, nr 8, datë 29. 01.2021 "Për Miratimin e Vlerës Maksimale të Subvencionimit të Qirasë dhe të Nivelit të Qirasë në Treg të Lirë", Proces-Verbalin e Komisionit të Strehimit, datë 21.02.2022, nr 1725 prot, "Për Miratimin e Vlerës si dhe Listës së Përfituesve për Programin e Subvencionimit të Qirasë në Tregun e Lirë nga Fondet e Buxhetit të Shtetit dhe Bashkisë Gjirokastër", Këshilli i Bashkisë, Gjirokastër 28/02 2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI.

- 1- Miratimin e listës së 20 individëve/familjeve dhe vlerën e subvencionit të qirasë
- 2- Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë 1 (një vjeçare) dhe vlera financiare për llogaritjet që nga dita e lidhjes së kontratës së qirasë.
- 3- Efektet financiare që rrjedhin nga pika "1", në shumën totale 271.000 lekë/muaj, nga të cilat 143.000 mijë lekë nga Buxheti i Shtetit, si dhe 128.000 lekë/muaj, nga bashkia Gjirokastër.
- 4- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, si dhe Drejtoria e Financës.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të tij.

SEKRETARE E KËSHILLIT

ETLEVA YZO

